- Jepë orarin punëtorëve dhe vozitësve me ç'rast jep udhëzime mbi organizimin e ngarkimit dhe transportit në bazë të planeve dhe prioriteteve ditore.
- Për punën e tij i përgjigjet udhëheqësit të shërbimeve te përbashkëta
- Kushtet: teknik i komunikacionit me deshmi mbi njohurit profesionale. dhe tri (3) vite përvojë pune.

- **Automekanik (3)**

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku tre (3) vitë përvojë pune
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (600 pikë).

Detyrat e punës:

- Punon drejtpërdrejti në ndreqjet dhe mirëmbajtjen e të gjitha automjeteve dhe paimeve me të cilët disponon transporti.
- Punën e kryen me vegla doracake dhe makine. Kryen edhe punë tjera të cilët ja cakton udhëheqësi I drejtpërdrejtë.
- Drejtpërdrejti është përgjegjes që punën ta kryej sipas rregullave dhe dispozitave për operacionin e caktuar.
- Gjatë punës është I obliguar ti përbahet rregullave dhe dispozitave të mbrojtjes në punë.
- Drejtpërdrejti I përgjigjet udhëheqësit të transportit.
- Kushtet: -Mjeshtër I degës maqinerike – automekanik dhe tri (3) vite përvojë pune.

- **Depoist/e në depon doracake në transport (1)**

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku tre (3) vitë përvojë pune
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (550 pikë).

Detyrat e punës:

- Sipas dokumentacionit përcjellës bën pranimin e mallit në depo.
- Kontrollon sasinë dhe kualitetin e mallit të dërguar nga furnizuesi dhe nëse material nuk i përgjigjet kualitetit apo sasisë së kërkuar sipas tenderit te shpallur dhe kontratës së lidhur me furnizuesin , materialin e tillë nuk e pranon dhe kërkon nga furnizuesi t'i eliminoj të metat e reklamuara dhe për këtë menjëherë i raporton drejtorit të NjB-MFKA .
- Bën fletëpranimin e materialit të pranuar dhe atë e nënshkruan se malli është pranuar.
- Bën deponimin (radhitjen) e mallit sipas llojit dhe destinimit të tij . 

- Përcjell me rregull hyrjet dhe daljet e mallit nga depoja dhe përpilon dokumentacionin e nevojshëm për to.
- Jep punëtorëve materialin për nevojat e punës së përditshme sipas kërkesave të materialit të cilat i lejon udheheqesit te njesis biznesore apo personi i autorizuar nga udheheqesit te njesis biznesore
- Kujdeset për mbajtjen në rregull të depos dhe materialit të deponuar.
- Për punën e tij i përgjigjet përgjegjësit te depos qendrore .

- **Vozitës i mjeteve të rënda (4)**

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme të ulët
- Duhet të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (650 pikë).

Detyrat e punës

- Punon në punët e drejtimit të mjetit motorik gjatë ngritjes, ngarkimit, transportit dhe shkarkimit të pjesve reserve, repromaterialit, materialit të nxjerur jashtë përdorimit etj;
- Pastron, lubrifikon, rregullon dhe mirëmban mjetin në gjendje të rregullt;
- Është përgjegjës për gjendjen e rregullt të mjetit, gjegjësisht për shërbime të rregulla dhe mirëmbajtjen e të njëjtit;
- Punon sipas nevojës edhe punë tjera sipas urdhërit të mbikëqyrësit të operatives;
- Obligohet që ti përdorë mjetet imbrojtëse në punë;
- Përgatitjes profesionale: KL/KM dega e drejtimit të transportit, me provim të dhënë të vozitësit të kategorisë B;

- **Vozitës (8)**

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku tre (1) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (570 pikë).

Detyrat e punës

- Drejtpërdrejti punon në punët dhe manipulimin me automjet me peshë deri në 12 ton.
- Kombi dhe automobil udhëtarësh, më që rast para fillimit të punës kryen kontrollën vizuale të paisjeve: dritat, frejt, sistemin e drejtimit, gjendjen e pneumaticëve, kontrollën

BVL

e karburantit, vojit, lëngut ftohës, sipas nevojës kryen ndreqjet të vogla dhe të njejtat I mirëmban.

- Me rastin e transportit të materjalit kontrollon saktësin e masës gjatë ngarkimit (pranimit) dhe dorëzimit.
- Gjatë vozitjes së njerzëve kujdeset për siguri e tyre.
- Jep llogari mbi hargjimin e karburantit, lubrififikuesit dhe lëngut ftohës.
- Kujdeset për zbatimin e dispozitave ligjore teknike të mbrojtjes në punë, conform dispozitave të komunikacionit.
- Për punën e tij I përgjigjet udhëheqsit të transportit.
- Kushtet: - Dega e komunikacionit vozitës I kategorisë B-C.

- Autoclektricist (2)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku një (1) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (600 pikë).

Detyrat e punës

- Punon dejtpërdrejtë në ndreqjet dh emirëmbajtjen e elektropaisjeve dhe instalimeve të të gjithave automjeteve me të cilat disponon transporti.
- Kryen kontrollin e përditshëm mbi gjendjen e rregullt të elektropaisjeve në automjete.
- Kryen edhe punë tjera të cilët ja cakton udhëheqësi i transportit në kuadër të aftësis së tijë profesionale.
- Punën e kryen me vegla doracke.
- Drejtpërdrejti eshtë përgjegjës që punën ta kryen sipas dispozitave dhe rregullave.
- Zbaton rregullat e mbrojtjes në punë – gjatë punës
- Për punën e tij I përgjigjet udhëheqsit të transportit.

- Punëtor në peshore (4)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku një (1) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (550 pikë).

Detyrat e punës

- Punon ne punet e matjes se mases e xehrorit qe vjen nga miniera, koncentratit te Pb,Zn, piritit te cilat dergohen ne Peshore si materialeve tjera, -Kujdeset per manipulimin e

drejte dhe mirembajtjen e Peshores, afatin e vlefshmerise se certificaten per kontrolin e peshores , evdentine sakte te masave te matura si dhe per pasterti dhe perpikmerine e hapesires punuese ne ambientin e tij punues.

- Eshte perjegjes per zbatimin e drejtperdrejt te masave per mbrojtje ne pune. -Per punen e tij eshte perjegjes operatives se jashme ne kuader te Nj.P.
- Për punën e tij i përgjigjet udhëheqsit të transportit.

Mensa në Kishnicë

- Udhëheqës i menzes (1)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (610 pikë).

Detyrat e punës

- Është përgjegjës për koordinimin dhe bashkërendimin e rendit, orarit të punës, orarit të ushqimit, përgatitjeve paraprake të mbrojtjes higjenike, të parapërgatitjeve dhe shpërndarjes të shujtave ushqimore me kalori, vitaminoze e minerale për minatorët dhe punëtorët jashtë minierës.
- Është përgjegjës për sigurimin e kushteve higjenike e sanitare për tërë personelin e restorantit të paraparë me rregullore dhe ligjin për konsumimin dhe shpërndarjen e artikujve e shujtave ushqimore për shërbime publike.
- Është përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorëve nga infektimet qofshin direket apo indirekte të punëtorëve apo personave të tretë siç janë; shpërndarja e ushqimit të prishur, skadimit të asfatit të artikujve ushqimorë, papastërtia, hedhja e paqëllimit të lëndëve kimike në racionet e nxeha, përdorimi i melmesave me afate të tejkaluara që ambulazha është e mbuluar me një datë të re etj.
- Është përgjegjës që në restorant gjatë furnizimit me ushqim dhe artikuj ushqimorë të kenë vulën sanitare si dhe licencën e artikujve ushqimorë të lejuar për ushqim nga Qeveria e Kosovës.
- Është përgjegjës për mbrojtjen higjenike e sanitare të personelit të punëtorëve dhe tërë objektit si nga brenda dhe jashtë sajë,mbeturinat ushqimore dhe gjësendet tjera të erosura apo të prishura duhet të asgjësohen me komision dhe të hidhen jashtë objektit si është e paraparë me ligj.
- Drejtpërsëdrejti përgjigjet menaxherit të minierës, kryen edhe punë me përgjegjësi tjera në bazë të rritjes të vëllimit të punëve në prodhimtari.
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqesit të shërbimeve të përbashkëta. 

- Gjellëbërse/a (4)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (590 pikë).

Detyrat e punës

- Është përgjegjës për higjenën personale e sanitare dhe personave ndihmës shërbyses gjatë ndërrimit të orarit të punës në përgatitjen e shujtave të racionit të nxehë apo të thatë.
- Është përgjegjës për përgatitjen e racioneve të ngrohta si nga cilësia, kualitetit, sasisë, vlerave nominale klorike të parapara me ligjin dhe standardet të konsumimit të ushqimeve për shërbime publike.
- Është përgjegjës për përgatitjet paraprake të racioneve ditore, javore dhe vikendore në përputhshmëri me kërkesat të menaxherit dhe udhëheqësve tjerë të minierës.
- Është përgjegjës që të përsosë literaturën e rregullave të përgatitjeve ushqimore të standardizuara me ligjet në fuqi për kuzhinën e shërbimeve publike.
- Drejtpërsëdrejti i përgjigjet mbikëqyrësit të ushqimit, kryen edhe shërbime tjera në bazë të rritjes së vëllimit të punëve.

- Ndihmës gjellëbërse/a (4)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku një (1) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (550 pikë).

Detyrat e punës

- I ndihmon ne kryerjen e puneve gjellebersit kryesor,
- Kujdeset per pastertin gjate përgaditjes se ushqimit te ngrohet dhe te ftoste .
- Për punën e tij i përgjigjet Mbikqyrsit te menses.

- Mirëmbajtës i paisjeve dhe hapësirës në menz (3)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme ose filllore
- Duhet të ketë së paku një (1) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (500 pikë). 

Detyrat e punës

- Është përgjegjës-se për kryerjen e punëve në bazë të urdhërave nga udhëheqës i menzes ose gjellëbërsi.
 - Është përgjegjës -për pastërtin higjenike e sanitare të sendeve kuzhinierë si janë;pjatat,lugët, pirunët,tabakave për servim, tavolinat, karriget që shërbejnë për servimin e ushqimeve të racioneve të ngrohta dhe të thata.
 - Drejtpërsëdrejti i përgjigjet urdhërave nga udhëheqës i menzes ose gjellëbërsi-ndihmsi, kryen edhe punë tjera
- Shërbimi i sigurimit dhë mbrojtjes në punë
- Drejtues i signrisë dhe mbrojtjes në punë (1)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare - drejtimi inxhinier i diplomuar i xehtarisë apo master ose drejtimi inxhinier i diplomuar i gjologjisë apo master
- Duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (1000 pikë).

Detyrat e punës:

- Kontrollon dhe ndihmon aplikimin e masave mbrojtëse në punë;
 - Organizon dhe avancon mbrojtjen në punë me udhëheqësit dhe ekipën e mbrojtjes;
 - Në bashkëpunim me shërbimin e mbrojtjes në punë, drejtorin teknik dhe udhëheqësit tjerë kujdeset për mbrojtjen kolektive në punë;
 - Në rast nevoje jep udhëzime me shkrim për punë drejtorëve teknik dhe udhëheqësve tjerë;
 - Është përgjegjës për azhurimin e planit të mbrojtjes në punë dhe aksionit të shpëtimit në rast të ndonjë fatkeqsie të papritur;
 - Është i obliguar që t'i përcjell rregullat në fuqi nga lëmia e mbrojtjes dhe rregullat e xehtarisë;
- Zyrtar i mbrojtjes në punë (2)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare drejtimi inxhinier i diplomuar i xehtarisë apo master ose drejtimi inxhinier i diplomuar i gjemologjisë apo master,
- Duhet të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune,
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (800 pikë) 

Detyrat e punës:

- Është përgjegjës për depot e eksplozivit jashtë miniere si dhe në minierë, bënë kontrollin dhe mbikëqyrë shpërndarjen e rregullt te lëndës plasëse si dhe kujdeset për mbarëvajtjen e sigurisë rreth depove;
- Kujdeset për sigurinë në punishtet në minierë dhe stabilimentet përcjellëse në minierë;
- Kujdeset për mjetet e mbrojtjes në punë, zbatueshmërinë e rregulloreve në fuqi;
- I përgjigjet udhëheqësit të shërbimit të mbrojtjes në punë dhe direkt udhëheqësit të njësisë biznesore;
- Kryen dhe detyra tjera sipas hierarkisë së njësisë udhëheqëse;

- Teknik i çetës së shpëtimit (7)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (640 pikë).

Detyrat e punës:

- Kontrollon dhe mirëmban pajisjet e çetës së shpëtimit;
- Pastron dhe mirëmban ambientin në zyrën e çetës së shpëtimit;
- Merr pjesë në trajnimet e rregullta të çetave të shpëtimit dhe kujdeset për gatishmërinë e plotë të tyre për veprim sipas formacionit;
- Kryen punët administrative nga fushëveprimi i vet;

- Laboratori

- Drejtues i laboratorit (1)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare - drejtimi inxhinier i diplomuar i teknologjisë ushqimore apo master, kimist i diplomuar apo master, biolog i diplomuar apo master si dhe çdo drejtim tjetër relevant i shkencave natyrore
- Duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (790 pikë).

Detyrat e punës:

- Organizon koordinimin e punës prej marjes së mostres (sektori i përgatitjes) gjëre te përfitimi i rezultatit (sektori i analistikës) me analiza kimike dhe instrumentale si dhe përcaktimin e metodave të punës;
- Mbikëqyrë punën dhe punon me Absorber Atomik;
- Punon ujërat me A.A. te cilat merren nga rrjedhja e minierës dhe deponia në Badovcit; 

- Raportet e analizave kompoziteve mujore dhe 3 mujore i dorëzohen Drejtorit te Flotacionit;
- Raportin e punës dhe të gjitha analizat gjatë muajit ia raporton drejtorit të minierës;
- Kordinohet me kryepuntorët për punën e marrësve të mostrës në repart, përgatitësave të mostrës, matjen me peshoren digitale, marrjen e mostrave nga kamionat gjatë bartjes së koncentratit, dhe formimin e llojave te cilat kryhen së bashku me përfaqësues të kompanisë e cila e blen koncentratin ku së bashku me ta përcaktohet edhe lagështia e koncentratit të Pb dhe Zn;
- Përgjigjet për paisjet e laboratorit dhe kryen planifikimin e furnizimit gjatë vitit, si dhe per mërimbajtjen e aparaturave;
- Kujdeset për sigurimin e mjeteve mbrojtëse për puntorë;
- Bënë kordinimin e punëve me repartin e elektromakineris për riparimet e nevojshme;
- Bashkunon me drejtorin e flotacionit dhe drejtuesin e prodhimit për përcjelljen e procesit teknologjik dhe kontrollimin e kualitetit të reagensave nga ana e laboratorit;

- **Udhëheqës të përgatitjes së mostrave dhe analitikes (2)**

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhinier i diplomuar i teknologjisë ushqimore apo master, kimist i diplomuar apo master, biolog i diplomuar apo master si dhe çdo drejtim tjetër relevant i shkencave natyrore
- Duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (670 pikë).

Detyrat e punës:

- Përgjigjet për përgatitjen e tretjeve apo reagensave të nevojshëm për kryerjen e të gjitha analizave kimike në Laboratori;
- Bënë përgatitjet e tretjeve dhe reagentave për analizat në volumetri;
- Përgatitjen e tretjeve dhe reagjensave në kompleksometri;
- Përgatitjen e standardeve për graviometri;
- Përcakton standardin e reagensave për volumetri dhe kompleksometri;
- Për analiza Instrumentale për të gjitha elementet (Pb, Zn, Fe etj.)
- Asiston në punët që bëhën në Absorber Atomik;
- Përgatit tretjet, standardet bazë për Absorber Atomik (të të gjitha elementeve);
- Punon me aparatin e destilimit të ujit për nevojat e laboratorit;
- Përgjigjet për sigurimin e të gjitha reagensave dhe enëve laboratorike (furnizimi);

- **Kryepunëtor ndërrimi në laboratori (3)**

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (620 pikë). *PW*

Detyrat e punës:

- Zbaton urdhërat që i merr nga krypunëtori kryesor, dhe udhëheqësit tjerë përkatës;
- Ka për detyrë të bëj përcjelljen imbarëvajtjen e punëve në përgatitje dhe analistikë;
- Punon me laborantin (teknikun e parë) analizat e ndërrimit;
- Punon analizat gjeologjike;
- Raporton kryepunëtorin e ndërrimit me rezultatin e analizave të ndërrimit në flotacion;
- Bashkëpunon me kryepunëtorin e flotacionit dhe brigadirin e përgatitjes;
- Është përgjegjës për disiplinë dhe sigurinë e punëtorëve që i ka në ndërrim;
- Bënë përcjelljen e mënyrës së marrjes së mostrave të analizave laboratorike;
- Pranim - dorëzimi i punës duhet të bëhet në vendin e punës;
- Për zbatimin dhe mos zbatimin e detyrave të punës i nënshtronhet masave stimuluese dhe ndëshkuese, sipas rregullores së punës;
- Ka për detyrë t'u përbahet rregullave të punës;
- Me urdhër të udhëheqësit përkatës angazhohet edhe në punë tjera, si p.sh. gravimetri, mostra gjeologjike etj. Nëse paraqitet nevoja edhe jashtë orarit të punës;

- Laborant (10)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (580 pikë).

Detyrat e punës:

- Filtëron dhe përgatit mostrat e ndërrimit të flotacionit dhe drumcorës;
- Kryen përgatitjen e mostrave gjeologjike;
- Kryen perqatitjen e mostrave mujore dhe 3 mujore;
- Pergatit mostrat e koncentratit të Pb dhe Zn të marrura në Kamiona (Llotat)
- Është i ngarkuar me imbarëvajtjen e marrësve të mostrave në ndërrim;
- Bashkëpunon me kryepunëtorin e ndërrimit;
- Sipas nevojës kryen edhe punë të tjera;

- Departamenti i Hulumtimeve dhe Investimeve

- Drejtori i departamentit për hulumtime dhe investime (1)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhinier i diplomuar i gjeologjisë apo master
- Duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (1050 pikë). 

Detyrat e punës:

- I raporton Drejtorit Teknik të minierës dhe Drejtorit të Njësisë Biznesore;
- Është përgjegjës për udhëheqjen dhe menaxhimin e Departamentit për Hulumtim dhe Zhvillim si një proces permanent i cili zgjatë aq sa zgjatë vet jeta e minierës;
- Merret aktivisht me hulumtim si proces kompleks dhe shumë i rëndësishëm për jetëgjatësinë e minierës;
- Mbledhë, përpunon dhe interpreton informacione dhe rezultate mbi të cilat mund të mirret vendimi për shfryezimin racional të vendburimit;
- Me anë të hulumtimit siguron të dhëna për madhësinë, formën dhe pozitën hapësinore të vendburimit minerar, për kualitetin e xehes dhe kushtet e vendburimit duke siguruar ekonomicitet dhe arsyeshmëri më të madhe për shfrytëzim të xehes;
- Duke u bazuar në të dhënat mbi sasinë, gjegjësish mbi rezervat e xehes dhe kualitetin e saj, mund të cakton vlerën e xehes në vendburim;
- Menaxhon dhe organizon shpenzimet e hulumtimit në atë mënyrë që të harmonizohen me çmimet e metaleve në treg në mënyrë që shpenzimet për hulumtim të kenë arsyeshmëri ekonomike në raport me xehes në treg;
- Ka nën mbikqyrje Shërbimin Gjeologjik të minierës të cilin e ndihmon, i jep rekomandime dhe sygjerime profesionale rreth organizimit të punëve hulumtuese dhe interpretimit të rezultateve si dhe shtimit të performancës;
- Ndihmon Shërbimin Gjeologjik në organizimin e procesit të shpimeve të thella hulumtuese dhe në interpretimin e rezultateve që arrihen përmes shpimeve të thella hulumtuese duke quajtë rritjen e efektivitetit të rezultateve të shpimeve;
- Ndihmon në interpretimin e analizave kimike dhe mineralogjike të mostrave për vërtetimin e prezencës së komponenteve të dobishme dhe koncentrimit të tyre;
- Me analizën inxhinierike të rezultateve të nxjerra nga shpimet hulumtuese dhe analizat kimike-laboratorike, ndihmon në arritjen e koncepteve të interpretimit të vendburimit xehleror me të dhëna për madhësinë, formën dhe përbërjen e komponenteve të dobishme, gjegjësish për hulumtimin e rezervave xehlerore;
- Është përgjegjës për të ndihmuar në marrjen e vendimeve të drejta inxhinierike në fushën e hulumtimit dhe zhvillimit;
- Përcjell zbatimin e projekteve dhe raporton në baza të rregullta periodike;
- Bashkërendon aktivitetet me Departamentet tjera të Njësisë Biznesore për identifikimin e nevojave dhe fushave për hulumtim dhe zhvillim në arritjen e objektivave të Njësisë Biznesore dhe përkrahje të projekteve hulumtuese;
- Përgatitë planin vjetor të hulumtimit, zhvillimit dhe menaxhimit të projekteve nga kategoria investime kapitale;
- Është përgjegjës dhe ka nën menaxhim dy njësitë e hidrombushjes të cilat i ndihmon në marrjen e vendimeve të drejta dhe të arsyeshme për performimin e procesit të hidrombushjes në ambientet minerare dhe rritjen e performances vepruese; 

- Njësia e shërbimit gjeologjik
- Drejtues i shërbimit gjeologjik (2)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhinier i diplomuar i gjeologjisë ose master
- Duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (980 pikë).

Detyrat e punës:

- Në bazë të projektit të shpimeve të hartuar nga gjeologët në shërbimin gjeologjik, inxhinieri i shpimit duke u bazuar në prerjen gjeologjike të formacioneve që do të shpohen, harton projektin teknik të shpimeve dhe ky projekt teknik i bashkangjitet projektit gjeologjik t'ë shpimeve duke formuar kolonën gjeologo-teknike të shpimeve;
- Inxhinieri i Shpimit është personi teknik që përgjigjet për kryerjen e shpimeve sipas projektit të hartuar;
- Për çdo shpim që do të kryhet në funksion të formacioneve gjeologjike harton konstruksionin e pusit të shpimit;
- Përcakton parametrat e regjimit të shpimit për tu zbatuar nga Kryepuntori i njësisë së shpimeve të thella hulumtuese gjatë shpimit të pusit, duke lënë me shkrim dhe me goje;
- Në rastet kur takohen shtresa mineralmbajtëse, përcakton një regjim shpimi të veçantë me të cilin do të shpohet në trupat xeheror në mënyre që të përcaktohet saktë fillimi dhe mbarimi i trupit xeheror;
- Përcakton masat teknike për eliminimin e devijimeve të shpimeve;
- Kontrollon gjendjen e instrumentave teknologjik në makinën e shpimit dhe bën rigjenerimin e tyre për të eliminuar ndonjë avari të mundëshme në këto instrumenta;
- Harton programin e likuidimit të avarive të ndryshme që mund të ndodhin gjatë punës së makinës së shpimit;
- Në rast avarie, inxhinieri i shpimit drejton direkt punën për likujdimin e avarisë në bazë të programit të punës së hartuar prej tij;
- Inxhinieri i Shpimit është personi përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e makinerisë, duke përcaktuar masa për shërbimet dhe riparimet në makineri paisje të makinës së shpimit;
- Inxhinieri i Shpimit bën trajnimin dhe përgatitjen e specialistëve të rinj për të punuar në proceset e shpimit;
- Zbaton me korrektesi rregullat e sigurimit teknik dhe bën instruktimin e vazhdueshëm të punëtorve për zbatimin e rregullave të sigurisë dhe mbrojtjes në punë;
- Kryen detyra të tjera sipas nevojës;
- Respekton dhe zbaton rregullat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë;

- Inxhinier kryesor në shërbimin gjeologjik (2)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhinier i diplomuar i gjeologjisë ose master
- Duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale

- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (900 pikë).

Detyrat e punës:

- Inxhinieri kryesor i Sherbimit Gjeologjik, për menagjimin, kryerjen e detyrave dhe pergjegjësive te tij i përgjigjet drejtpërdrejt Drejtorit të Sherbimit Gjeologjik.
 - Organizon punët dhe ndanë detyrat dhe përgjegjësit tek inxhinierët përkatërkatës, për kryerjen e detyrave të ndara sipas plan-programit të hartuar nga Sherbimi Gjeologjik.
 - Planifikon dhe realizon hulumtime themelore gjeologjike, hulumtime aplikative gjeologjike të rëndësishme për minierën, studime gjeologjike sistematike nëpërmjet hartografimeve komplekse të shkallëve të ndryshme.
 - Studime gjeokimike të vendburimit dhe përpilimin e hartave gjeologjike
 - në shkallë të ndryshme, plotësimin e hartave ekzistuese me informacione të reja me qëllim të zbulimit dhe marrjes së informacioneve të duhura mbi: ndërtimin
 - gjeologjik, gjenezën, karakteristikat cilësore dhe sasiore të mineraleve dhe resurseve gjeologjike.
 - Inxhinieri përgjegjës për shpime të thella i raporton drejtpërdrejt inxhinierit kryesor në Sherbimin Gjeologjik dhe Udhëheqësit të Sherbimit Gjeologjik.
 - Ofron mbështetje teknike dhe teknologjike për operacionet e shpimit dhe gjithashtu merr pjesë në planifikimin e operacioneve të shpimit dhe zhvillimin e pjesës prodhuese dhe teknike të dokumentacionit të projektimit dhe vlerësimit.
 - Merr pjesë në organizimin dhe likuidimin e operacioneve të shpimit dhe harton dokumentacionin teknik (urdhra gjeologjiko-teknike, harta regjimi dhe teknologjik etj.) për ndërtimin e puseve dhe kontrollon zbatimin e tij.
 - Cakton përgjegjësitë për transportin e mostrave deri në vendin e caktuar për to.
 - Kryen orientimin e mostrave, matë fortësin e parafërt, cakton intervalet për prerjen e mostrave, dhe merrë të gjitha masat e nevojshme për evidentimin e saktë në bazën e të dhënave të shënimeve për mostrat si ato litologjike, orientimit, fortësisë, llojit të xeherorizimit.
 - Bënë përgaditjen definitive të mostrave me të gjitha shënimet e nevojshme për dërgimin në laboratoret përkatëse.
 - Inxhinieri i shpimit të puseve është përgjegjës për moskryerjen ose kryerjen e pahijshme të detyrave të tyre sipas këtij përshkrimi të punës - në përputhje me ligjet e punës në fuqi.
- **Inxhinier përgjegjës për shpime të thella (3)**

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhinier i diplomuar i gjeologjisë ose master
- Duhet të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (850 pikë)

Detyrat e punës:

- Përgatit dhe jep detyra për ekipin e gjeologëve dhe teknikëve të shpimeve; 
- Përgatit planit të biznesit në bashkëpunim me ekipin;

- Interpretimi dhe integrimi i të dhënavëve të gjeologjike, duke përfshirë të dhënat gjeologjike rasonale, të dhënat historike të hulumtimit dhe të dhënat gjeofizike dhe gjeokimike për të vlerësuar kontrolllet rasonale mbi mineralizimin dhe për të përcaktuar objektivat e hulumtimit;
- Projektimi dhe interpretimi nëpërmjet softuerëve profesional si: ArcGIS, MapInfo, Data Mine (3DCivil);
- Analizimi, vlerësimi dhe përshkrimi i formacioneve gjatë shpimit në formularë të dokumentimit gjeologjik dhe futja e të dhënavëve data bazë;
- Vlerësimi i të dhënavëve detajuara të hulumtimit në njërin nga softuerët profesional qoftë edhe 3D për të vlerësuar tiparet gjeometrike të shfaqjeve të mineralizuara, për të përcaktuar kontrolllet mbi mineralizimin dhe për të identifikuar objektivat e shpimit;
- Projektimin e shpimeve hulumtuese në bashkëpunim me ekipin punues;
- Caktimin e zonave perspektive mineral mbajtëse, hartografimin dhe interpretimin gjeologjik të tyre;
- Llogaritjen e rezervave gjeologjike ne bashkëpunim me ekipin;
- Përgatit raporte sipas nevojës në baza ditore, javore, mujore dhe vjetore;
- Siguron që aktivitetet gjeologjike të kryhen sipas standardeve dhe politikave të ndërmarrjes, në përputhje me rregulloret lokale dhe në një mënyrë të sigurt duke synuar zero lëndime ose raste të trajtimit mjekësor;
- Merr masa për ruajtjen e ambientit gjatë fazës së shpimit, duke këshilluar dhe parandaluar derdhjen e vajrave dhe lubrifikantëve që përdorë gjatë shpimeve;

- **Inxhinier për shpime të thella (2)**

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhinier i diplomuar i gjeologjisë ose master
- Duhet të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (800 pikë).

Detyrat e punës:

- Mbikëqyr çdo fazë të procesit të shpimit;
- Ndihmon në përgatitjen e planit të biznesit;
- Merr përgjegjësi të plotë për marrjen e vendimeve për ndaljen ose vazhdimin e shpimit;
- Cakton dhe mban përgjegjësi për orientimin (drejtimin) e shpimit;
- Komunikon rregullisht me zyri e shërbimit gjeologjik dhe ekipin punues ne vend punishte;
- Krahason të dhënat e mbledhura gjatë shpimit me parashikimet e bëra në fazën e planifikimit;
- Këshillon për rreziqet e gjatë fazës së shpimeve dhe rekomandon marrjen e masave mbrojtëse dhe parandalues;
- Raporton për çdo incident potencial tek udhëheqësi i shërbimit gjeologjik; 

- Merr masa për ruajtjen e ambientit gjatë fazës së shpimit, duke këshilluar dhe parandaluar derdhjen e vajrave dhe lubrifikantëve që përdorë gjatë shpimeve;
- Mbajta e shënimeve të detajuara, shkrimi i raporteve, plotësimi i regjistrave të raportimit ditor, favor dhe dërgimi i tyre në departamentet përkatëse;

- **Inxhiner për hartografim dhe digitalizim (2)**

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhiner i diplomuar i gjeologjisë ose master
- Duhet të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (800 pikë).

Detyrat e punës:

- Planifikoni projekte gjeologjike dhe projekton marrjen e mostrave;
- Përgatit harta topografike dhe gjeologjike;
- Përgatit dhe hartografon punishte në minierë dhe i digitalizon ato;
- Përgatit prerje-profile gjeologjike;
- Përgatit dhe digitalizon harta gjeologjike, digitalizon trupat xheror në minierë në minierë, etj;
- Ndihmon në përgatitjen e planit të biznesit;
- Kryen Hartografim dhe interpretim gjeologjik me softuerë profesional ArcGIS etj;
- Ndihmon në përgatitjen e raporteve të brendshme gjeologjike që përbledhin rezultatet e programeve në terren dhe rekomandon aktivitetet e propozuara pasuese;
- Kryerja e programeve të hartografimit të detajuara në minierë dhe vendosja e të dhënave në hartë, vlerësimi i kontrolleve strukturore dhe stratigrafike mbi mineralizimin dhe zbatimi i rezultateve të kësaj pune në përcaktimin e shpimeve;
- Siguron që të respektohen rregulloret mjedisore dhe të tjera në projektet e hulumtimit dhe prodhimit;

- **Inxhiner për projektim dhe licencim (2)**

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhiner i diplomuar i gjeologjisë ose master
- Duhet të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (800 pikë).

Detyrat e punës:

- Përgatit elaborate gjeologjike në bashkëpunim me ekipin për licencim të ndërmarrjes;
- Është përgjegjës për mbajtën nën kontroll të afateve kohore të licencave të shfrytëzimit dhe hulumtimit;
- Përgatit të gjithë dosjen e nevojshme për licencim dhe vazhdim të licencimit; 
- Përgatit raportet mujore, tremujore dhe vjetore;
- Përgatit planit të biznesit në bashkëpunim me ekipin;

- Inxhiner për kontroll të kualitetit (2)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhiner i diplomuar i gjeologjisë ose master
- Duhet të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (800 pikë).

Detyrat e punës

- Përgatit planin e mostrimit te vazhdueshëm në minierë dhe sipas nevojës edhe jashtë saj;
- Së bashku me asistentin teknik marrin mostra në vazhdimësi në trupat xeherorë për të përcaktuar kualitetin e xeherorit;
- Respekton standarde mostrimit;
- Përgatit raporte rreth mostrave dhe skicon formën e mostrimit;
- Ndihamon në përgatitjen e planit të biznësit sipas të dhënave të grumbulluara;
- Së bashku me asistentin bëjnë prerjen e kampionëve sipas nevojës;
- Përgatit formën standarde të paketimit ruajtjes dhe dërgimit të mostrave në laborator;
- Përgatit raporte duke përfshi raportin e analizave;

- Inxhiner i hidrogjeologjisë (2)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhiner i diplomuar i gjeologjisë ose master
- Duhet të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (800 pikë).

Detyrat e punës:

- Monitoron nivelin e ujërave nëntokësore dhe ndikimin e ujërave sipërsaqësore;
- Mban informata të vazhdueshme rreth cilësisë dhe sasisë ujërave nëntokësore;
- Përgatit elaborate hidrogjeologje dhe gjeologo-inxhinierike sipas nevojës;
- Harton projekte per trajtimin e ujrale nëntokesore;
- Në bashkëpunim me inxhinierin e hidroteknikes përgatit elaborate për licencim;

- Inxhiner për hidroteknik (1)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhiner i diplomuar i gjeologjisë ose master
- Duhet të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (800 pikë). *DNV*

Detyrat e punës:

- Mbikëqyrë nivelin e ujërave nëntokësore dhe ndikimin e tyre sipërsaqësore;
- Mban informata të vazhdueshme rreth të dhënavë për burime dhe resurse të reja;
- Përgatit elaborate hidrogeologjike dhe gjeologo-inxhinierike sipas nevojës;
- Harton projekte per trajtimin burime të reja të resurseve;
- Harton dhe përgatit elaborate për licencim;

- Asistent teknik për mostrim (4)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (690 pikë).

Detyrat e punës:

- Asiston Gjeologun, Hidrogeologun për punë në terren dhe minierë;
- Ndihmon ekipin;

- Mekanik në shpime (3)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (720 pikë).

Detyrat e punës:

- Mirëmbanë makinat e shpimit dhe është përgjegjës për mirëmbajtjen e tyre;
- Është përgjegjës për udhëheqjen e punës në rregullimin e desekteve kryesore në makinën e shpimit;
- Identifikon mungesat e pjesëve të makinën e shpimit dhe ndihmon në porositjen e tyre përfurnizim;
- Përcjell gjendjen teknike të pjesëve të makinës së shpimit dhe të makinës në përgjithësi;
- Respekton dhe zbaton rregullat e sigurusë dhe mbrojtjes në punë; *Tu/✓*

- Operator shpimi (4)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (760 pikë).

Detyrat e punës:

- Mirëmbanë makinat e shpimit dhe është përgjegjës për mirëmbajtjen e tyre;
- Është përgjegjës për udhëheqjen e punës në rregullimin e defekteve kryesore në makinën e shpimit;
- Identifikon mungesat e pjesëve të makinën e shpimit dhe ndihmon në porositjen e tyre përfurnizim;
- Përcjell gjendjen teknike të pjesëve të makinës së shpimit dhe të makinës në përgjithësi;
- Respekton dhe zbaton rregullat e sigurusë dhe mbrojtjes në punë;

- Furnizues i shpimeve të thella (1)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (620 pikë).

Detyrat e punës

- Identifikon mungesat e pjesëve të makinën e shpimit dhe ndihmon në porositjen e tyre përfurnizim;
- Përcjell gjendjen teknike të pjesëve të makinës së shpimit dhe të makinës në përgjithësi;
- Furnizon dhe zbaton rregullat sigurimit të furnizmit të rregullt në njësinë e shpimeve; 

- Departamenti i Shërbimit Teknik, Gjeodezik dhe Përgatitjes në Minierë
- Drejtori i departamentit të shërbimit teknik, gjeodezik dhe përgatitjes në minierë (1)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare - drejtimi inxhinier i diplomuar i xehtarisë apo master ose inxhinier i diplomuar i gjeologjisë ose master
- Duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (995 pikë)

Detyrat e punës:

- Organizon punën e shërbimit gjeologjik;
- Udhëheq dhe drejton punët profesionale në shërbimin gjeologjik, duke përfshirë hulumtimin dhe gjetjen e trupave xehror me anë të shpimeve hulumtuese kërkimore dhe metodave tjera hulumtuese;
- Hartografimin e punishteve dhe punimeve minerare;
- Marrjen e mostrave dhe analizimin e tyre me qëllim të llogaritjes së përbajtjes të komponentës së dobishme;
- Interpreton rezultatet e fituara nga analizat laboratorike të mostrave gjeologjike dhe nga mostrat e shpimeve hulumtuese;
- Punimi i projekteve të ndryshme për shpime hulumtuese kërkimore, shpime teknike etj;
- Llogaritjen e rezervave gjeologjike për tërë zonën e licencuar për hulumtim dhe shfrytëzim;
- Përgaditë raporte të rregullta mijore dhe të tjera sipas nevojës, për punën e shërbimit gjeologjik;
- Bashkëpunon me udhëheqësit e departamenteve tjera rrëth punëve hulumtuese dhe punëve tjera gjeologjike në minierë;
- Bashkëpunon me njësinë e prodhimit rrëth kordinimit të punës së hulumtimit me atë të prodhimit;
- Përgaditë planet për pozicionet dhe drejtimet e shpimeve të thella hulumtuese;
- Marrjen, dokumentimin dhe arkivimin e të dhënave gjeologjike të minierës;
- Zbaton të gjitha rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë;
- I përgjigjet drejtorit për hulumtim dhe zhvillim;

- Shërbimi Teknik
- Udhëheqës i shërbimit teknik (2)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhinier i diplomuar i xehtarisë apo master ose inxhinier i diplomuar i gjeologjisë ose master
- Duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (980 pikë). *W.M.*

Detyrat e punës:


- Bashkëpunon me drejtorin e departamentit të shërbimit i përgatitjes teknike, gjeodezik dhe përgatitjes në minierë;
- Bashkëpunon me ekipet profesionale të shërbimit gjeologjik, gjeodezik dhe përgatitjen teknike;
- Kujdeset për zhvillimin profesional të bashkëpunëtoreve;
- Kujdeset për menaxhimin e projekteve sipas udhëzimeve me Drejtorin e departamentit të shërbimit teknik;
- Monitoron dhe vlerëson zbatimin e projekteve sipas projektuesit;
- Vlerëson për zbatim projektet e thjeshtëzuara;
- Bën prezantimin e projekteve së bashku me projektuesin para drejtorit të departamentit të shërbimit teknik si dhe para udhëheqësit të njësisë biznesore para implementimit;
- Kryen punët administrative nga fushëveprimi i vet;
- Ofron ndihmë në menaxhimin e projekteve të tjera, si dhe kryen punë të tjera në pajtim me kualifikimin e drejtuesit të përgatitjes teknike;

- Inxhinier për projekte më minierë (1)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhinier i diplomuar i xehtarisë apo master ose inxhinier i diplomuar i gjeologjisë ose master
- Duhet të ketë së paku tre (3) vite përvjohje pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (850 pikë).

Detyrat e punës:

- Bashkëpunon me Shefin e shërbimit teknik dhe Drejtorit të shërbimit teknik.
- Bashkëpunon me teknikun;
- Përgatit planet operative mujore, bënë zgjidhjen teknologjike me synim të arritjes së prodhimit.
- Kontrollon dhe mbikëqyrë punën më minierë për zbatimin e projekteve;
- Jep udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar shërbime profesionale dhe cilësore ne fushën e zbatimit të standardeve dhe rregullave teknike; 
- Monitoron dhe vlerëson zbatimin e projekteve;
- Kryen punët administrative nga fushëveprimi i vet;
- Kryen edhe detyra shtesë sipas nevojës;

- Teknik i projekteve (1)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë e shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku një (1) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (650 pikë).

Detyrat e punës:

- Bashkëpunon me Inxhinierin projektant, me Shefin e shërbimit teknik dhe Drejtorin e shërbimit teknik;
 - Përgatit hartat dhe të dhënrat për implementimin e projekteve;
 - Kontrollon dhe mbikëqyrë punën në minierë për zbatimin e projekteve;
 - Monitoron zbatimin e projekteve;
 - Kryen punët administrative nga fushëveprimi i vet;
 - Kryen edhe detyra shtesë sipas nevojë;
- Shërbimi gjéodezik
- Udhëheqës i shërbimit gjéodezik (1)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhinier i diplomuar i gjéodezis apo master ose inxhinier i diplomuar i xehetaris ose master, Inxhinier apo master në gjéologjisë
- Duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (925 pikë).

Detyrat e punës:

- Bashkëpunon me drejtorin e departamentit të shërbimit të përgatitjes teknike;
- Bashkëpunon me ekipet profesionale të shërbimit gjéologjik, gjéodezik, xehetarisë dhe përgatitjen teknike;
- Kujdeset për zhvillimin profesional të bashkëpunëtoreve;
- Kujdeset për menaxhimin e projekteve sipas udhëzimeve të drejtorit të departamentit të përgatitjeve teknike;
- Kryen punët administrative nga fushëveprimi i vet;
- Ofron ndihmë në menaxhimin e projekteve të tjera, si dhe kryen punë të tjera në pajtim me kualifikimin e Gjéodezisë.

- Gjedjet në minierë (2)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare – drejtimi inxhinier i diplomuar i gjéodezisë ose master
- Duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (800 pikë). *ZM*

Detyrat e punës:

- Bënë matjet gjeodezike të punishteve, korridoreve, oxhaqeve dhe çka do që është e nevojshme në minierë dhe jashtë miniere;
- Shënon në minierë të gjitha drejtimet e korridoreve, spiraleve, punishteve, oxhaqeve etj;
- Matjet gjeodezike i vendos në plan 1:200, 1:500, dhe 1:1000;
- Kryen të gjitha aktivitetet e matjeve gjeodezike dhe inspektimin në minierë si dhe verifikimin e të gjitha koordinatave
- Bashkëpunon me ekipet profesionale të shërbimit gjeologjik, gjeodezik dhe përgatitjen teknike;
- Kujdeset për zhvillimin profesional të bashkëpunëtoreve;
- Kujdeset për menaxhimin e projekteve sipas udhëzimeve të Drejtuesit të shërbimit gjeodezik;
- Kryen punët administrative nga fushëveprimi i yet;
- Ofron ndihmë në menaxhimin e projekteve të tjera, si dhe kryen punë të tjera në pajtim me kualifikimin e Gjeodezisë;

- Teknik gjeodezisë në minierë (1)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë e shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (700 pikë).

Detyrat e punës:

- Bënë matjet gjeodezike të punishteve, korridoreve, oxhaqeve dhe çka do që është e nevojshme në minierë dhe jashtë miniere;
- Shënon në minierë të gjitha drejtimet e korridoreve, spiraleve, punishteve, oxhaqeve etj;
- Matjet gjeodezike i vendos në plan 1:200, 1:500, dhe 1:1000;
- Kryen të gjitha aktivitetet e matjeve gjeodezike dhe inspektimin në minierë si dhe verifikimin e të gjitha koordinatave;
- Bashkëpunon me ekipet profesionale të shërbimit gjeologjik, gjeodezik dhe përgatitjen teknike;
- Kujdeset për zhvillimin profesional të bashkëpunëtoreve;
- Kujdeset për menaxhimin e projekteve sipas udhëzimeve të drejtuesit të shërbimit gjeodezik;
- Kryen punët administrative nga fushëveprimi i vet;

- Figurant (2)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë e shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku një (1) viti përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (620 pikë).

Detyrat e punës:

- Së bashku me gjeodetin bënë matjet gjeodezike të punishteve, korridoreve, oxhaqeve dhe çka do që është e nevojshme në minierë dhe jashtë minierë;
 - Kryen të gjitha aktivitetet e matjeve gjeodezike në minierë.
 - Bashkëpunon me ekipe profesionale të shërbimit gjeodezik dhe përgatitjen teknike;
 - Kryen punët administrative nga fushëveprimi i vet;
 - Kryen punë të tjera në pajtim me shërbimin gjeodezik;
-
- Shërbimi i përgatitjes xehtarë në minierë
 - Udhëheqës i shërbimit të përgatitjes xehtarë (1)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare - drejtimi inxhinier i diplomuar i xehtarisë gjeologjisë ose master;
- Duhet të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale;
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (950 pikë).

Detyrat e punës:

- Kujdeset për mostrimin e rregullt të punishteve, hartografin e punishteve sipas projekteve dhe sipas udhëzimeve me drejtuesin e shërbimit gjeologjik;
- Përcjellin shfrytëzimin e punishteve, varfërimin si dhe bënë llogaritjen e rezervave;
- Jep urdhëresa dhe udhëzime gojore apo me shkrim në momente të duhura kur paraqitet problemi me stabilitetin e punishteve në minierë apo në sipërfaqe, bën përcjelljen e çdo ndryshimi në teren, krijimi i qarjeve, lëvizjen e masave, rrjedhjen e ujërave etj;
- Është i obliguar të bëj dokumentimin gjeologjik për çdo fenomen që ndodhë në minierë apo sipërfaqe në mënyra të ndryshme si me hartë, me shkrim, fotografji etj. dhe këto të dhëna ti arkivoj;
- Është përgjegjës për realizimin e detyrave gjeologjike që i përkasin minierës;
- Kryen punët administrative nga fushëveprimi i vet;
- Ofron ndihmë në menaxhimin e projekteve të tjera, si dhe kryen punë të tjera në pajtim me kualifikimin e drejtuesit të përgatitjes teknike;

- Kryepunëtor (1)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare - drejtimi inxhinier i diplomuar i xehtarisë ose master;
- Duhet të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale;
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (900 pikë).

Detyrat e punës:

- Organizon dhe udhëheq punën në horizont jep udhëzime profesionale për punë;
- Furnizon horizontin me material dhe vegla pune;
- Kordinon punët me horizontet me kryepunëtorin dhe mbikëqyrsin nëpër ndërrime;
- Me drejtuesin e qarkullimit propozon dhe llogarit normat dhe materialin e punës;
- Rregullon planin operativ mujor;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e objekteve, binarve, gypave te ajrit, ujit dhe pastërtinë në horizont;
- Është përgjegjës për realizimin e planit të prodhimit punimin e objekteve minierare, ajrimin dhe sigurinë në horizont, kryen edhe punë tjera me marrveshje;
- Aplikon të gjitha masat mbrojtëse në kuadër të horizontit të vet dhe rregulloret e xehetarisë;
- Aplikon masat e parapara mbrojtëse nga ana e inspektorit dhe shërbimeve mbrojtëse në punë;
- Kontrollon aplikimin e masave mbrojtëse në punë;
- Kontrollon sigurinë në punë në të gjitha proceset;

- Mbikëqyrës (1)

Kushtet:

- Të posedojë diplomë e shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (800 pikë).

Detyrat e punës

- Në mënyrë organizative është i lidhur drejtpërdrejt me kryepunëtorin e horizontit;
- Organizon dhe udhëheq punën gjatë ndërrimit jep udhëzime profesionale për punë në punishte dhe në vende tjera të punës;
- Jep orarin e punëtorve nëpër vende të punës dhe është përgjegjës për realizimin e detyrave dhe planit të ndërrimit;
- Rregullisht bënë kontrollimin e punishteve se paku një herë ne ndrrim e sispas nevojes shumë herë, vërejtjet të cilat i vëren i shkruan në librin e horizontit;
- Kontrollon përdorimin e mjeteve mbrojtëse të punës, si dhe mirëmbajtjen e daljes së dytë.

- Është përgjegjës për shpërndarjen sipas rregullave të lëndëve eksploduse gjatë ndërrimit, si dhe për kontrollin e harxhimit të tij;
- Në fushëveprimin e punës së tij i zbaton njëjtë të gjitha masat mbrojtëse sipas rregullave të aplikushëm në xehetari;
- Është përgjegjës për sigurinë e çdo punëtori në punë dhe gjatë ndrrimit;
- Gjatë kontrollimit jep urdhëresa gojore për eliminimin e rreziqeve të mundëshme punëtorve dhe ndihmësave të tij - parapunëtorve si dhe i urdhëron për eliminimin e tyre;
- Të gjithë punëtorve që kanë ardhur në punë të pa rregullt i largon nga vendi i punës për shkak të rregullave të mbrojtjes në punë;
- Është përgjegjës për vlersimin e normave: Shpim-Ngarkim;

- **Departamenti i Flotacionit**
- **Drejtori i Flotacionit (1)**

Kushtet:

- Të posedojë diplomë universitare - drejtimi inxhinier i diplomuar i xehetarisë apo master Inxhinier i diplomuar i metalurgjisë apo master apo fushat tjera nga inxhinieria industriale;
- Duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale
- Pikët sipas strukturës organizative dhe vlerës së koeficientit (1050 pikë).

Detyrat e punës:

- Bashkëpunon me drejtorin Teknik dhe Udhëheqesin e Njësisë Biznesore në drejtim të realizimit të planeve dhe objektivave të njësisë;
- Bashkëpunon me ekipet profesionale të përpunimit të xhes, mirëmbajtjes elektro makinerike dhe teknologjike të procesit të prodhimit;
- Ne bashkëpumim me Mbikëqyrës e reagjentëve përcjell gjendjen dhe harxhimin e të gjithë reagjentëve në depo dhe mbanë evidencën e harxhimit të tyre.
- Kujdeset për zhvillimin profesional të bashkëpunëtoreve;
- Kujdeset për menaxhimin e prodhimit të Pb dhe Zn sipas udhëzimeve me përgjegjësin e përpunimit;
- Monitoron dhe vlerëson zbatimin e prodhimit sipas plani të biznesit;
- Vlerësim për zbatimin e projektet e thjeshtëzuara;
- Kryen punët administrative nga fushëveprimi i vet;
- Ofron ndihmë në menaxhimin e projekteve të tjera, si dhe kryen punë të tjera në pajtim me kualifikimin e dhe përgatitjen teknike;
- Përcjell dhe mbikëqyr përdorimin e reagencave siasp standardeve.
- Mbikqyr kontrollin e kualitetit te xhes dhe koncentratit në bazë të analizave laboratorike ne menyrë sistematike
- Për punë dhe detyra të punës i përgjigjet Udhëheqësit të Njësisë Biznesore Minierat me Flacion Kishnicë dhe Artanë.

- Zëvendës Drejtor i Flotacionit
